



Anita Pajaziti është nxënëse në Shkollën “Nikolla Shtejn” në Tetovë. Arsimin fillor e ka kryer në Shkollën “Fan Noli” të f. Pallaticë. Kjo është vepra e parë e saj. Poezitë e saja i ka të postuara të faqja e shkollës ku dhe ka kryer arsimin fillor. Poezia e parë e postuar në faqen e shkollës fillore është “A thua vallë” me të cilën nis dhe rrugëtimin deri në botimin e kësaj vepre. Me krijimet e saja poetike është shfaqur në shumë manifestime shkollore e komunale të organizuara nga institucione të ndryshme. Ka marrë pjesë në konkurse letrare poetike të organizuara nga institucione komunale e regjionale. Është anëtare e Shoqatës së shkrimtarëve “Oeneum” të Tetovës si dhe anëtare në Shoqatën për kulturë dhe shkencë “Pellazgët” Tetovë. Bashkëjeton me familjen në f. Pallaticë

ANITA PAJAZITI - E PATHËNA

# Anita Pajaziti



## E PATHËNA

Tetovë  
2022

# Anita Pajaziti



# E PATHËNA

Tetovë  
2022

Anita Pajaziti

E pathëna

Maj  
2022

*Redaktor:* Muaxher Haruni

*Rradhitja:* Emin Haruni

*Shtypi:* Tringa Design - Tetovë

*Tirazhi:* 300



*“Fjalët kanë energjinë dhe fuqinë që të ndihmojnë, të shërojnë, të pengojnë, të lëndojnë, të dëmtojnë, të poshtërojnë, dhe të përulin”*

## *Fjalë të pathëna.*

---

*Të pathëna në këtë botë  
Kanë ngelur plotë,  
Herë me qëllim  
Herë nga guximi që se kemi dot.*

*Dhe ato fjalë dashurie  
As në heshtje si thonim,  
Kur ishim të rinj  
E s'mund t'i themi dhe sot.*

*Dhe ike nga kjo botë,  
Me fjalë të pathëna,  
Më pas më braktisën  
Dhe fjalët e thëna.*

*Më kanë braktisur të gjithë  
Më ka braktisur dielli,  
Më ka braktisur hëna,  
Ikën dhe yjet, rufetë dhe vetëtimat,  
Trembem se do më braktis,  
Një ditë edhe e pathëna.*

## *A thua vallë*

---

*Sonte është natë  
Dhe jam në vetmi,  
Po shikoj qiellin e hënën  
Në gjithë këtë errësirë.  
Ndriçon hëna e yjet,  
Në këtë nënqiell,  
Në këtë errësirë,  
Ndriçonte më tepër,  
I vetëm një yll.  
Në rrugën e errësires, a thua vallë,  
Se prindërit e mi do i bëj një ditë  
Edhe unë krenar,  
A thua se do më shemben të gjitha ëndërrat  
E do bien për tokë,  
Duke prekur e lagur tokën me pika lot.  
A thua vallë kjo dashuri  
Që kam ndaj kësaj rruge do ndriçoj  
Fatin e jetës do ma zbukuroj.*



## *Vjeshtë*

---

*Me kohë dhe koha hesht,  
Edhe stina e vjeshtes ashtu është  
Filloin gjethve t'iu ik ngjyra!?  
Qielli zbehet,  
Dhe qielli fillon të flet,  
Duke pikuar pika shiu në tokë.  
Dhe dielli i bukur nuk ndriçon  
Në ftyrat e njerëzve !  
Dhe ftyrat e bukura nisin mos flasin,  
Por zbehen si qielli i stinës së vjeshtës.*

## *Hija e Zjarrit*

---

*Sa bukur po shikoj  
Hije zjarin  
Në këtë ditë dimri,  
E zjari në oxhak flakëron,  
Të na ngroh shpirtin,  
Të na ngroh trupin,  
Nga të ftohti.*

*Zjarri që shpirtin të djeg,  
Ndodhin flakë të mëdha,  
S'mund të shuhen.  
Askush nuk mund të vërej këtë,  
Përveç shpirtit tonë  
I cili përjetion këto dhimbje të mëdha.  
Dhe mungesa e shpirtit  
Që duam ta kemi pranë,  
Mungesa e tij do më mungoj përjetsisht,  
Të cilin nuk mund ta pranoj  
Humbjen e mungesën pranë atij personi!.*

## *Dashuri ndaj vetes*

---

*Nëse je i dashuruar  
Je njeriu me i lumtur,  
Prandaj ëndrro,  
Se një ditë do ia dalish për gjithçka,  
Nëse nuk ke shpresë  
Nuk arsyë për të dashurar.*

*Dashuria që të tjerët dashuron  
Dashuria ndaj prindërve tonë,  
Fëmijës, natyrës dhe vetes  
Kur në jetë nuk mbaron.  
Dashuria e shpirtit binjak është ndryshe,  
Ndiresh sikur je dashuruar,  
Me mijëra vjet njihesh.*

## *Hënë moj ku je?*

---

*A je zhdukur edhe ti, hënë moj,  
Në errësirën e përjetëshme,  
Pse më braktis edhe mua,  
Në këto netë dimri, më le të vetmuar?.*

*Hënë moj, pse nuk përgjigjesh,  
Me jep pak dritë që të rrezatoj  
Edhe unë si ti në errsirë?.*  
*Henë mos u largo nga unë, të lutem,  
Të gjithë largohen prej meje,  
Por ti mos u largo.*

*Tani jam pa shpresë  
Jam e vetmuar me plagë të thella,  
Askush nuk mund të më dëgjojë  
E askush nuk mund të më jep dritë, në errsirë!*

*Ndriço të lutem mos më lerë pa shpresë!*

## *Ku gjete dashuri të singertë*

---

*Ku gjete dashuri të singertë?*

*-Te babai!,*

*Kush të tha të dua siç je?*

*-Të tha babai, apo...!?*

*Kush të tha kurrë mos ndrysho?*

*-Të tha babai!*

*E kush të tha se je dashuria ime e vetme?*

*-Të tha babai apo jo?*

*E po atëherë*

*Pse thoni e gjeta dashurinë e jetës!,*

*Po pse nuk thoni kurrë,*

*Se gjeta dashurinë si të babit*

*I cili më do e më thotë;*

*Të dua ashtu siç je, Bija ime!.*

## *Ajo është Nëna*

---

*Kur ajo të përqafton,  
Dhimbjen ta lehtëson.*

*Asaj kur i tregon diçka,  
Gjithmonë të këshillon.*

*Ti kur je e lumtur,  
Ajo është dyfish me lumtur se ti.*

*Kur krenohesh ti me veten,  
Edhe ajo krenohet me ty!*

*Kur të qëllon të gabosh,  
Ajo gjithmonë të qëndron prapa kraheve!*

*Eh ti kur largohesh prej saj,  
Asaj i coptohet shpirti në çdo anë.*

*Çdo fjalë e saj të jep forcë,  
Në çdo copëz të jetës tënde!*

*Çdo fjalë e çdo kshillë e saj,  
Është magjike për mua!*

*Se në çdo rrugë të jetës të cilën po eci,  
Dhe po më drejton, janë fjalët e saj magjike!  
Të dua bija ime, të dua.*

## *Hija*

---

*Hija e diellit tash po të ndjek  
Dhe këmba këmbës të vjen pas,  
Hija e diellit s'të lë rehat.*

*Por hijen e tij nuk e humb kurrë,  
Deri tash sa hije të kanë ndjekur,  
Por si hija e tij nuk të ka ndjekur askush,  
Rrezja e diellit nuk është më.*

*Dhe ti tash nuk je më  
U shembe e bëre hija e hënës,  
E ai u kthye e bë hija e diellit,  
Tash nuk mund kthehesh  
Nën hijen e tijë.*

*Tash ajo shkëlqen nën hijen e hënës  
Nuk ka nevojë për hijen e diellit,  
Hija e tijë hija e diellit i duhet tash.*

*Bota është një libër, faqet e se cilit hapen përpara  
nesh në çdo hap që hedhim.*



## *Një botë e egër*

---

*Kur atë e përqafo,  
Dhimbjen e lehtëson,  
Sa i pafajshëm je,  
Në këtë botë të egër,  
Ty të tregon.*

*Të tregon se çka do thotë pafajësia,  
Të tregon se duhet të dashurosh,  
Të bën që ta harosh  
Të kaluaren tënde të errët,  
Të thotë duhet të jetosh.*

*Çdo buzëqeshje kur ta jep  
Është një dhurat për ty,  
Pra kjo është pafajësia e një fëmije  
Që jeton në një botë të egër...*

## *Lotët e sajë*

---

*Për ty u dogj e u shkri,  
Lotët e saja si lotë qiriu,  
Ngurtësohen, shkrihen, pikojnë,  
Dashurin në urejtje e konvertojnë..*

*Çdo fjalë që të tha  
Ishte një pendim për të,  
Ajo filloi të të urrente  
Edhe ty edhe emrin tënd.*

*Ajo u bë si një qiri, kudo shëndriste  
Por ishte e ngurtë kur i pikonin lotët..  
Pasi ashtu e bëre atë, ti!*

## *Dashuro*

---

*Të dua pa kushte  
Të dua pa mos ma thenë ti mua,  
Të dua, edhe unë të dua.*

*U dashurova tek buzqeshja yte,  
U dashurova tek shikimi yt,  
U dashurova në mënyrën se si ecish ti,  
U dashurova ne rahjet e zemrës tënde,  
U dashurova tek ti duke imagjinuar për ty,  
Mos më haro, ëndrrën mos ma shkatro.*

*U dashurova dita ditës tek ti,  
Duke u shfaqur pranë meje si fantazmë,  
E duke ikur prej meje, këtë mos haro.*

*U dashurova tek ti,  
More njeri, kupto,  
Çfar të bëj më,  
Këtë mos haro.*

*Më dashuro edhe ti mua,  
Siç unë u dashurova,  
Në çdo copëz të jetës tënde,  
Të lutem më rikujto, mos haro.*

## *Çdo lule ka aromë*

---

*Çdo lule ka aromë,  
Të mahnit e të qetëson,  
Plagët e shpirtit t'i shëron.*

*Lulen më të bukur  
Nënës sime ia dhuroj,  
Në ditën e sajë  
Tetë marsin t'ia uroj.*

*Lulen më të bukur  
Në shtëpi e kam,  
Ajo më zbukuron jetën  
E nuk lodhet duke më pritë.*

*Sa shumë fjalë  
Kam lules për ti thënë,  
Krijoj vargje për çdo ditë,  
Nënës time ia kushtoj  
Nënë të dua pa limit.*

## *Mos eja më*

---

*Shko, mos eja më,  
Për ty gjithçka mbaroi,  
Gjithçka përfundoi.*

*Si rezet e diellit  
Në mbrëmje kur perendojnë,  
Edhe për ty në këtë jetë  
Gjithçka është bë vonë.*

*Shko, ik e mos eja më  
Mos kthe kokën pas,  
Nuk dua të të shoh  
Asgjë s'më bëhet vonë.*

*Shko, fytyrën mos të ta shoh,  
Pasi duke të pritur unë ty,  
U bëra njejtë si lulet e diellit,  
Prandaj shko, ik e mos eja më...*

## *Ajo*

---

*Ajo është magjike,  
Ajo është tipike,  
Ajo të magjeps,  
Si magneti të tërheq.*

*Ditën të zbukuron  
Edhe hënës ia kalon,  
Është si yll është si dritë  
Që në qiell gjithmonë shëndrit.*

*Kur në jetë nuk paragjykon  
Dhe askë nuk ofendon,  
Bukuria e saj të mahnit  
Dhe gjithë botën e habit.*

*Mos tentoni ta ofendoni  
Sepse ashpër reagon,  
Me zërin e sajë si vullkan  
Të djeg e të përvëlon.*

## *Në amshim*

---

*Tërë kohën të kujtoj,  
Në amshim je ti,  
Kurë s'të haroj o Gjyshi im.*

*Pranë varezave kur kaloj  
Një zë sikur dëgjoj,  
Zemra më dridhet  
Kur rikujtoj Gjyshin tim.*

*Dua një përqaftim,  
Nga Gjyshi im,  
Dua vetëm një ditë,  
Të kthehesh në këtë botë,  
Të çmallem me Gjyshin tim.*

*Çdo buzëqeshje e imja  
Është tretur pa mbarim,  
Është kthyer në zhgënjim  
Sepse nuk e kam më, Gjyshin tim.*

*“Udhëtimi, ashtu si dashuria, shpreh një përpjekje  
për ta kthyer ëndrrën në realitet”*



## *Një udhëtim*

---

*Kaloi dete, kaloi oqeane,  
Ëndëronte të udhëtoj,  
Kontinentet t'i vizitoj.*

*Në rrugëtim rruga iu ndërpre,  
Dallgët e sulmonin, kur kishte furtunë,  
Ajo anije, ajo shpresë në oqean u zhyt.*

*Shumë ëndëra u ndërpre,  
Shumë dëshira morën fund,  
Shumë zemra nuk aritën,  
Në gadishullin e lumturisë,  
Në parajsën e dashurisë.*

## *Libri miku jetës sime*

---

*Sa libra kam lexuar  
E sa të tjerë dua të lexoj,  
Nga librat dituri dua të fitoj.*

*Libri është miku im  
Ai mua nuk më tradhëton,  
Fshehtësitë e jetës nuk mi shpalos.*

*Ai kur nuk të gënjen  
Është miku që nuk të përgojon,  
Është miku i jetës që kur nuk të tradhton.*

*Si një liber që ka histori  
Jeta jonë me të ka gjallëri,  
Libri është miku im i vërtetë  
Që të shoqëron në jetë.*

## *Më pëlqen të udhëtoj*

---

*Më pëlqen të udhëtoj  
Male e kodra ti kaloj,  
Të shkoj larg diku tjetër  
Në çdo stinë të jem në një qytet tjetër.*

*Dua të takoj njerëz të buzëqeshur,  
Dua të eci në rrugën e lumturisë  
Rrugën e lamtumirës ta haroj.*

*Shumë njerëz udhëtojnë,  
Rrugëtimin nuk din ta shijojnë,  
Ëndrat e tyre duan ti realizojnë,  
Në qytete të bukura dashurohen,  
E në fund mashtrohen.*

*E dua lirinë, e dua lumturinë,  
Dua kudo që të shkoj,  
Të gjej atë që dua,  
Atë që do çdo njeri në këtë jetë.*

## *Mos ma vrit ardhmërinë*

---

*Mos më thuaj mos,  
Mos më thuaj mjaft,  
Mos më thauj hesht,  
Mos më thuaj s'ke të drejt.*

*Mos me thuaj se kjo botë të mjafton,  
Mos më thuaj rruga yte ishte deri këtu,  
Mos me thuaj asgjë s'të intereson !.*

*Mos ma shkatro jetën duke me thënë mjaft  
Duke ma vrarë ardhmërin e krenarinë,  
Mua s'më mjafton një botë  
Dua të shijoj edhe përjetësinë.*

## *Kah lind dielli*

---

*Kah lind dielli  
Hija yte është atje,  
Kah lind dielli  
Gjithçka po shëndrit,  
Rrezet në çdo skaj lëshon  
Hijën tënde madhështon.*

*Dhe pas kodre dielli perendon  
Hëna rrezet i lëshon  
Hija yte edhe natën nuk perendon  
Ditë dhe natë hijëson.*

*Lindi dielli përsëri,  
Mbi kodrina lind shpëtimi,  
Lindi kënga e lumturisë,  
Lindi kënga e dashurisë,  
Rilind jeta e përjetësisë.*

## *Borës*

---

*Borë moj e bardhë që je  
Fushë e male i mbulove  
Edhe të ftohtin e solle.*

*Sa të gëzuar fëmijët që janë  
Gëzimin ua solli fjolla e parë,  
Luajnë e rëshqasin  
Me topa bore njëri-tjetrin e godasin.*

*Në këtë dimër të acartë,  
Do më mungoj trumcaku,  
Dallëndyshja dhe lejleku këmbë gjatë.*

*Në dimër rrugët gumzhojnë  
Gëzohen fëmijët  
Vjen plaku mjekërbardhë  
Të sjell dhuratën vitit të mbarë.*

*Në dimër mysafiri,  
Në obor po na vinë,  
Me kësul tenxherje,  
Me fshisë në dorë,  
Si rroje ushtari po ri.*

## *E pathëna*

---

*Hesht nuk tregon,  
Është thyer në shpirt për mbrenda,  
Nuk mund të tregon se sa vlen,  
Nuk mund të tregon se kush është.*

*Nuk mund të tregoj se çka mendon,  
Nuk mund të tregoj asgjë,  
Përveç që një zemer të thyer,  
E do sy me lotë të mbushur.*

*E cila është lodhur për gjithçka,  
Nuk dëshiron t'ia dijë për jetën,  
Nuk dëshiron t'ia dijë as për veten,  
As lotët nuk i fshinë pasi ajo hesht  
Dhe në vend të saj flasin lotët...*

## *Koha po kalon*

---

*Koha po kalon, dita po shkonë,  
Nata s'nalon, ec më tej në erësirë,  
Ora edhe më shumë vrapon,  
Sikur gjithçka tatëpjetë po shkon.*

*Sekondat duket se shkurtohen,  
Gjithçka më është errsuar,  
Për shkak kohës së mbaruar.*

*Nuk e dijmë ku ndodhemi  
Mbrenda kohës ku jetojmë,  
Jemi të zhdukur mbrenda  
Një erësire të përjetëshme.*

*Koha po kalon  
Kujtimet fshihen  
Ndryshojnë ndjenjat  
Njerëzit po mallkojnë.*

*Koha po kalon  
Dhe kështu qenka jeta,  
Koha po kalon  
Dhe jo e vërteta .*



## *Në lulishten e jetës*

---

*Sa lule kam për rreth  
Dhe nuk di se cilës më parë erë t'i marr,  
Ato shëndrisin, kopshtin zbukurojnë,  
Lule të bukura shumë ngjyrshe janë,  
Secila më e bukur se tjetra,  
Secila ka vlerën e vetë,  
Më shumë se një diamant vlejné.*

## *Vetmi nga shoqëria*

---

*Ke një shoqëri  
Të do kur je pranë tyre,  
E kur largohesh  
Fillojnë të flasin për ty,  
Ke një rreth shoqëror  
Por sa janë të vërtetë.*

*Ato sillen si miq  
Në të vërtetë armiq i ke,  
Ti u tregon çdo dhimbje  
Ato qeshin me dhimbjen tënde,  
Ti kur largohesh prej tyre,  
Ata të kërkojnë.*

*Vetmia është shoqëria yte  
Tek e cila mund të refeshesh për gjithçka,  
E jo në një shoqëri të shtirur.*

## *Tingujt e këngës*

---

*Nga po vjen kjo melodi  
Nga zëri i një femre,  
Që ta qetëson e shëron shpirtin  
E shëroj në çdo çast veten.*

*Te tingujt e këngës  
Së asaj vajze po gjej veten,  
Dita ime tash do fillojë me zërin e saj,  
Paska një zë magjik  
Që të shëron plagët e shpirtit.*

## *Je yll*

---

*Kudo që shkon, po shëndrit,  
Kudo që je, mirësi e dashuri sjell ndër ne,  
Sa herë të shikoj sytë e tu shëndrisin,  
Mirësitë e tua botën shashtisin.*

*Je një yll, kudo shëndrit,  
Në errësirë ti po bën dritë,  
E nëse nga unë largohesh një ditë,  
Përsëri në errësirë si yll do bësh dritë!*

## *Pse*

---

*Pse me dole përpara  
Kur të kisham haruar,  
Pse me përshëndete  
Fytyrën kurë, nuk ta kam rikujtuar.*

*Kur e dije si më le  
Kur u rëzova ti nuk ishe,  
U ngrita vetë pa ty  
Mos u intereso më për mua,  
Nuk ia vlen, nuk të dua.*

*E kotë është edhe nëse pyet  
Ndoshta për ty kam dashuri,  
Por nuk te jap përsëri edhe një mundësi  
Pasi gjithçka është kthyer në urretje.*

*Njerëzit vërtetë të medhenj janë ata që mund t'u  
japin shpresë të tjerëve.*

## *Shpresa*

---

*Çdo ditë zgjohesh me shpresë  
Çdo ditë beson se do bëhet për ty mirë,  
Çdo natë lutesh për të  
Që të realizohet ajo shpresë.*

*Ndonjëherë për asgjë nuk shpreson  
Lodhesh se kërkuari shpresë,  
Thua asgjë s'më mban në ketë jetë  
Por përsëri të nesërmen shpreson.*

*Edhe nëse i thua vetes mos shpresos,  
Ti përsëri do shpresosh,  
E di pse shpreson,  
Pasi nëse nuk shpreson,  
Nuk mund të dashurosh?!*

## *Aromë që nuk humb*

---

*Sa herë që shiu në dritare do trokas,  
Lulet do çelin ditë e natë.*

*Sa herë do ndjej aromën e lulve.  
Do vij aty tek dritarja të të shoh ty.*

*Edhe qelqi ka filluar të ndryshket,  
E lulet në të njejtin vend janë,  
E të njetën aromë mbajnë.*



## *Qiellit blu*

---

*Qiell blu sa i bukur që je, Sa  
bukur po shëndrit,  
Zogjtë rreth teje fluturojnë, Yjet që i  
ke, natën vizëllojnë.*

*Edhe hëna dritë te jep, Aurola  
kuror shëndrit, Qielli i kaltërt  
kaltëron, Bashkë me diellin,  
Bukurinë tënde madhështojnë.*

## *Kujtime shkollore*

---

*Sa kujtime e sa përjetime kemi,  
Sa gëzime e hidhrame përjetojmë,  
Këshillat e mësuesve nuk do i harojmë,  
Na udhëzojnë e për jetë na mësojnë.*

*Thonin që fjala  
E mësuesve nuk vlen,  
Na qortonin kot,  
Koha e tyre ka kaluar,  
Botën tonë nuk e kuptojnë,  
Por s'ishte e vërtetë,  
Çdo gjë që na thanë  
Ishte një mësim.*

*Shkollë e jona sa kujtime ke,  
Gjithmonë na kujton, kur nuk na haron,  
Herë pas here edhe ne do të vizitojmë,  
Kujtimet tona nuk na lë t'i harojmë .*

## *Sytë e tu*

---

*Duke kërkuar dritë në mes të natës  
Sytë e mi u zhytën në shiun e verës,  
Sa pika shiu pikuan  
Në natë vere qellin duke vështruar.*

*Lotët nuk po mbaronin  
Në atë natë vere,  
Lotët nuk pushonin  
Bukurinë e natës të shohin.*

*Nuk e di a do mbaronin lotët  
Dhe dritën e mëngjesit të shihnin,  
Të përfundonte ky ankth  
Dhe dritë të jetës të vinin.*

## *Pranvera*

---

*Ti ike udhës së pafundme  
Kur çelën lulet e pellgut të lumit,  
Dhe unë do shkoj do ulem mbi pellg  
Të shijoj aromën e luleve të bukura  
Të pelgut të lumit.*

*Sa lule për rreth pellgut paskan çelur  
Por si rrezja e dritës rezatojnë,  
Dielli shëndrit brigjet e lumit  
Gjallëron jetën në pellgun e lumit.*

## *Do flas*

---

*Do flas për fjalët që mi the,  
Do flas për shpresën që ma dhe,  
Do flas për ëndrrat që more,  
Do flas për lumturinë që ma vodhe,  
Do flas e nuk do hesht më,  
Do flas dhe për bukurin e vetes sime,  
Do flas për ty, deri sa të vdes,  
Do flas deri sa të përulesh,  
Do flas der sa të me lutesh,  
Për ty do flas emrin nuk do ta përmend,  
Do flas e do të godas,  
Aty ku me shumë të dhemb,  
Do flas e do godas aty ku se pret,  
Do flas pasi fjalët e mia,  
Ty do të ndjekin deri në amshim,  
Mos më thuaj që s'të thash,  
Deri sa të hakmerem, do vazhdoj të flas,  
Do flas skandal do të bej,  
Për të këqijat që mi bëre,  
Ty do të denoncoj,*

## *Pse buzëqesh*

---

*Pse në çdo moment buzëqesh,  
Pse çdo herë dashuri fal,  
A nuk je thyer asnjëherë  
A s'të kanë zhgenjyer në jetë.  
Nuk ke qenë e përlotur ndonjëherë,  
Po është e vërtetë se buzëqesh çdo here,  
Buzëqesh zhgënimit, marëzisë  
Buzëqesh dhe lumturisë  
Buzëqesh dhe fatit të njeriut  
Buzëqesh dhe halleve të mërgimit  
Buzëqesh edhe ti o njeri  
Buzëqesh ashtu siç di dhe vetëm ti.*

*Në përfundim të leximit të një libri ndihemi sikur po i  
japim lamtumirën një shoku të çmuar.*

## ***Disa fjalë rreth veprës***

*Çdo njërit në jetë i ngelin fjalë, të cilat në raste të caktuara nuk ka mundur t'i thotë, e të cilat i ngelin brengë dhe mesi pret momentin e rradhës ti shpreh e të thotë atë që e ka dhe brengë shpirtore. Në këtë libër Anita është munduar të mbledh fjalë të bukura, të mençura, kuptimplotë me të cilat ka paraqitur një tablo të qartë rreth botës që e rrethon, dhe dëshirën e saj se si do të duhet të duket ky realitet. Dëshira dhe puna permanente po ashtu nxitën Anitën që t'i ngjitet tatëpjetës së vështirë deri në realizimin e këtij projekti. Jo rrallë herë ka patur edhe vështërsi të cilat i ka kaluar në momentin që ka shfletuar literaturën përkatse dhe është interesuar që t'i zberthej problemet që i dilnin gjatë krijimeve të vjershave të kësaj vepre. Poezia e parë e postuar te faqja e shkollës fillore " Fan Noli " është " A thua vallë " me të cilën e nis rrugëtimin e gjatë deri në botimin e këtij libri, rrugëtim që ka qenë sa i lodhshëm aq edhe emocional dhe me dëshirën për të aritur atë që në momente është duk i pamundshëm.*

A thua vallë kjo dashuri  
Që kam ndaj kësaj rruge do ndriçoj  
Fatin e jetës do ma zbukuroj.



*Anita nuk humb mundësinë për të mësuar diçka, mundohet dhe në shumë raste dhe ia arinë të thotë atë që dëshiron, arinë ta realizoj ëndrrën e sajë, ta zbukuroj fatin e jetës.*

*Jeton në këtë realitet por nuk i mungojnë edhe ëndrrat e saja për një të ardhme më të mirë, jo vetëm jeta personale por edhe shoqërore. I pëlqen ta paraëndrroj fatin e jetës, në disa vargje dhe sikur parandjen për atë që mund ti ndodhe në një ta ardhme.*

*Duke lexuar librin Anita Pajazitit futem nëpër labirinthe e temave që ajo trajton me një qasje krejt ndryshe, origjinale dhe autoktone të sajë. Zhytet thellë në zbërthimin e temës nga vargu në varg, kërkon që çdo krijim i saj të etablohet fortë pas unit të saj, mundohet të jetë vetja dhe origjinaliteti. Në krijimet e saja Anita ka përdor shumë figura letrare të cilat i ka mësuar si nxënëse në arsimimin e sajë; si metaforën, simbolin, alegorinë etj. Ndërton varg me rrokje te ndryshme. Po ashtu ndërton strofë me vargje të ndryshme. Në përgjithësi krijimet e Anitës janë reflektim ndaj botës në të cilën jeton. Reflekton mbi atë që e sheh, ndjenë dhe e kupton, e mbi to reflekton duke dhënë edhe ide se si duhet të ndryshohet edhe ardhmëria e sajë në veçanti, dhe ardhmëria e shoqërisë në përgjithësi.*

*"Kujt i është dhënë natyra të flasë, ai do të jetë në gjendje të këndojë. Kujt i është dhënë të ecë, ai mund të kërcejë."-thënie popullore.*

*Dhe me sa duket Anitës në momentit që iu dha rasti, i tha fjalët e pathëna . Shpresoj që Anita do vazhdojtë krijoj krijime letrare lirike, po nuk do lë anash edhe krijimet letrare epike të cilat janë edhe synimi i së ardhmes.*

Muaxher Haruni

## *Falemenderim*

*Pas një pune të gjatë, pas shumë lodhjeshe e sakrificash arrita të botoj librin tim të parë. I falemenderoj të gjithë ata të cilët më mbështetën moralisht e materialisht që edhe unë të arij të kurorëzoj punën time dhe të realizoj ëndrën time që të rradhitem në mesin e krijuesëve të vendit tim.*

*Falemenderoj familjen time për përkrahjen morale e materiale, falemnderoj të gjithë ata që gjatë tërë kohës më stimulonin që të vazdhoj punën krijuese.*

*Një falenderim të singertë për arsimtarin Muaxher Haruni, me të cilin jam konsultuar dhe i cili më ka përkrahur e ndihmuar për çdo gjë deri në botimin e kësaj vepre.*

*Të nderuar lexues të fjalës së bukur, ju faleminderoj që që lexuat librin tim të parë. Ishte kënaqësi për mua që ta ndaja me Ju këtë vepër.*

*Me respekt  
Anita Pajaziti*

## ***Përmbajtja***

<i>Fjalë të pathënam.....</i>	5
<i>A thua vallë .....</i>	6
<i>Vjeshtë.....</i>	7
<i>Hija e Zjarrit .....</i>	8
<i>Dashuri ndaj vetes.....</i>	9
<i>Hënë moj ku je?.....</i>	10
<i>Ku gjete dashuri të singertë .....</i>	11
<i>Ajo është Nëna.....</i>	12
<i>Hija.....</i>	13
<i>Një botë e egër.....</i>	15
<i>Lotët e sajë .....</i>	16
<i>Dashuro.....</i>	17
<i>Çdo lule ka aromë .....</i>	18
<i>Mos eja më .....</i>	19
<i>Ajo .....</i>	20
<i>Në amshim.....</i>	21
<i>Një udhëtim .....</i>	23
<i>Libri miku jetës sime .....</i>	24
<i>Më pëlqen të udhëtoj .....</i>	25
<i>Mos ma vrit ardhmërinë .....</i>	26
<i>Kah lind dielli.....</i>	27
<i>Borës .....</i>	28
<i>E pathëna .....</i>	29
<i>Koha po kalon.....</i>	30
<i>Në lulishten e jetës.....</i>	31
<i>Vetmi nga shoqëria.....</i>	32
<i>Tingujt e këngës.....</i>	33

<i>Je yll</i> .....	34
<i>Pse</i> .....	35
<i>Shpresa</i> .....	37
<i>Aromë që nuk humb</i> .....	38
<i>Qiellit blu</i> .....	39
<i>Kujtime shkollore</i> .....	40
<i>Sytë e tu</i> .....	41
<i>Pranvera</i> .....	42
<i>Do flas</i> .....	43
<i>Pse buzëqesh</i> .....	44
<i>Disa fjalë rreth veprës</i> .....	46
<i>Falemenderim</i> .....	48
<i>Përmbajtja</i> .....	49

















Anita Pajaziti është nxënëse në Shkollën “ Nikolla Shtejn” në Tetovë. Arsimin fillor e ka kryer në Shkollën “Fan Noli” të f. Pallaticë. Kjo është vepra e parë e saj. Poezitë e saja i ka të postuara të faqja e shkollës ku dhe ka kryer arsimin fillor. Poezia e parë e postuar në faqen e shkollës fillore është “A thua vallë” me të cilën nis dhe rrugëtimin deri në botimin e kësaj vepre. Me krijimet e saja poetike është shfaqur në shumë manifestime shkollore e komunale të organizuara nga institucione të ndryshme. Ka marrë pjesë në konkurse letrare poetike të organizuara nga institucione komunale e regjionale. Është anëtare e Shoqatës së shkrimtarëve “Oeneum” të Tetovës si dhe anëtare në Shoqatën për kulturë dhe shkencë “Pellazgët” Tetovë. Bashkëjeton me familjen në f. Pallaticë